

**Aneksi A****SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

| Nr. | Pozicioni i punës                          | Struktura e interesuar/<br>Forca | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve |            | Afati i aplikimit |            |
|-----|--|----------------------------------|------------------|----------------------------|---|------------|-------------------|------------|
|     |  |                                  |                  |                            | Me dosje                                | Intervista | Fillimi           | Mbarimi    |
| 1   | <b>Specialist për aktivitete kulturore</b> | Reparti Ushtarak nr.6004, QKMB   | Tiranë           | Pa afat                    | Po                                      | Jo         | 24.09.2020        | 28.09.2020 |
| 2   |  |                                  |                  |                            |   |            |                   |            |
| 3   |  |                                  |                  |                            |   |            |                   |            |

Formulari nr. 1

|   |
|---|
| <b>1.Pozicioni i punës:</b> Specialist për aktivitetet kulturore, në Sektorin e Aktiviteteve Sportive, në QKMB dhe Muzeu i FA.  |
| <b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A  |
| <b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak Nr.6004, QKMB dhe Muzeu i FA   |
| <b>4. Vendi:</b> Tiranë   |
| <b>5. Paga:</b> VKM nr.202, datë 15.03.2017, i ndryshuar  |
| <b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat   |
| <b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 24.09.2020  |
| <b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 28.09.2020  |
| <p><b>9. Mënyra e aplikimit:</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:</p> <p><i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i></p> <p><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p> |

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al) (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- |                                       |   |
|---------------------------------------|---|
| a. Grada/Titulli:                     | Civil/Specialist per aktivitete kulturore         |
| b. Arsimi :                           | I mesëm i përgjithshëm ose profesional /Bachelor. |
| a. Kualifikimi:                       | Në interes te funksionit të kërkuar               |
| b. Trajnimi:                          | Trajnim në fushën e kërkuar                       |
| c. Eksperienca në Punë:               | Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vjet.              |
| d. Gjuha e huaj:                      | E preferuar Anglisht                              |
| e. Kërkesa të tjera specifike:        | Të ketë njohuri të mira ne fushën e kerkuar.      |
| f. Niveli i certifikatës së sigurisë: | N/A   |

## Përshkrimi i punës:

### **Detyrat kryesore:**

1. Organizon, mbështet dhe sugjeron aktivitete kulturore për personelin e Forcave të Armatosura, për bashkëshortet dhe fëmijët e tyre, si dhe për publikun e jashtëm.
2. Jep in putet e fushës së tij në plane vjetore, afatgjatë dhe afatmesëm të QKMBMMFA.
3. Mban një praktikë të saktë të çdo aktiviteti të karakterit kulturor të organizuar nga Sektori i Aktiviteteve Sportive.
4. Bashkëpunon me strukturat e karakterit kulturor ose rekreacional në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA.
5. Harton informacionin për punën e kryer dhe zbaton detyrat që merr nga Përgjegjësi i Sektorit të Aktiviteteve Sportive;

### **13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.